



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

V.KD. NR. 5-4/2021

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Bajram Lajqi - Kryetar, Adnan Pacolli dhe Fitim Shporta - anëtar, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Ajeti, Administratore në zyrën Disiplinore të OAK-së, në çështjen disiplinore sipas propozimit 8-3/2020 të dt. 10.09.2021 të Prokurorit Disiplinor të OAK-së, kundër avokatit _____ nga _____, me adresë në _____, të cilin e përfaqëson _____ nga _____, në bazë të nenit 51 paragrafi 1, nënparagrafi, 1.1. të Ligjit për Avokatinë, nr. 04/L-193, nenit 118 paragrafi 1 nën par.1.3 të Statutit të OAK-së, dhe neneve 35 e 36 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit kryesor, me dt. 25.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I paraqituri, _____ nga _____ me seli të zyrës së avokatisë në adresën _____, " _____ " p.nr, me nr. të reg. _____ të OAK-së:

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse,

Me dt.22 dhe 23.01.2020, gjatë deklaramit të tij në emisionin _____ në televizionin _____, ka deklaruar dhe ka përdorur fjalët "*Aktakuza nuk ishte e _____; Aktakuza ishte e _____*", "*_____ duhet të frigohet nga ndërgjegja e vetë e sëmurë*", "*_____ komplet ka treguar se është pjesë e klanit pronto*", dhe në portalin _____ ka deklaruar se "*_____ e dënojë _____*".

Me çka, ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 par.1 pika 1.3 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 5, 6, 8, 37 dhe 38 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokatë, sepse me deklaramet e bëra ka vepruar në kundërshtim me aktet normative të OAK-së, ka cenuar autoritetin e avokatisë, dhe nuk ka ruajtur autoritetin e prokurorit të çështjes dhe Gjykatës si dhe ka dhënë deklarata fyese dhe ka paraqitur mendime nënçmuese ndaj prokurorit të çështjes.

Andaj,

Kolegji Disiplinor i OAK-së, në pajtim me nenin 51 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Avokatinë, dhe nenit 122 të Statutit të OAK-së, të paraqiturit, avokatit _____, i shqipton masën disiplinore:

V Ë R E J T J E

I. **Obligohet** i paraqituri _____, që në emër të paushallit disiplinor të paguaj shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë) Euro.

II. Paga e paushallit duhet të bëhen në buxhetin e OAK-së, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Me dt.10.09.2021, Prokurori Disiplinor i OAK-së, në Komisionin Disiplinor ka paraqitur propozimin disiplinor nr. 8-3/2021, kundër të paraqiturit av. _____ nga _____, me adresë në _____, me nr. të reg. _____ të OAK-së, me propozimin që të zhvillohet procedura disiplinore kundër tij. Propozimi është bërë në bazë të fletëparaqitjes disiplinore të ushtruar nga ish-Prokurori i PSRK-së _____, që mban numrin 133/20 e dt.30.01.2021.

Kolegji Disiplinor, me dt.21.09.2021, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar dhe pasi shqyrtoi Propozimin e Prokurorit Disiplinor nr. 8-3/2021, dt.19.09.2021, me provat e bashkangjitura, konstatoi se ekziston arsyeja e bazuar për vazhdimin e procedurës disiplinore ndaj avokatit _____ nga _____

Kolegji Disiplinor, mbajti seancën e shqyrtimit kryesor më datën 25.10.2021, në prezencën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së, z. Rexhep Veseli, në mungesë të ushtruesit të fletëparaqitjes _____ dhe në mungesë të të paraqiturit av. _____ i cili e kishte pranuar ftesën në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar, por prezent ishte përfaqësuesi i Autorizuar me shkrim i të paraqiturit Avokati _____ nga _____, me numër të lisencës _____, i cili për mungesën e të paraqiturit deklaroi se i njëjti nuk ka mundur të prezentoj në këtë seancë për arsye se gjindet në një seancë gjyqësore në Ferizaj apo Gjilan, por nuk prezentoj ndonjë provë për ta dëshmuar një gjë të tillë.

Kolegji Disiplinor pas verifikimit dhe konstatimit se i paraqituri av. _____ është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e shqyrtimit kryesor, ndërsa i njëjti nuk prezanton në seancë dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, atëherë vendosi që seanca e shqyrtimit kryesor të mbahet në mungesë të të paraqiturit _____, dhe me praninë e përfaqësuesit të autorizuar të tij, pasi që për këtë janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 28 paragrafi 2 i Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikant.

Kolegji Disiplinor i OAK-së, konform dispozitave të nenit 25, 29, 30,31, 33 dhe 34 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së, pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës kryesore, deklarimit të Prokurorit Disiplinor të OAK-së dhe të autorizuarit të të paraqiturit Av. _____ se nuk kishin vërejtje në përbërjen e kolegjit disiplinor dhe procesmbajtëses, hapi seancën kryesore të shqyrtimit disiplinor me njoftimin e çështjes disiplinore sipas Propozimit të Prokurorit Disiplinor me nr. 8-3/2021 të datës 10.09.2020.

Prokurori Disiplinor, z. Rexhep Veseli deklaroi: ZPD në OAK me dt.03.02.2020 ka pranuar fletëparaqitje nga _____ (në atë kohë _____), kundër _____ me nr. të licensës _____ të dt.17.05.2002, me pretendimet se i njëjti ka përdorur shprehje jo adekuate në fjalën përfundimtare të dorëzuar lidhur me lëndën _____ dhe gjithashtu edhe gjatë prononcimit në emisionin Interaktiv të dt.22.01.2020 në Televizionin dhe në deklaratën për portalin _____ të dt.22.01.2020. Pas zhvillimit të hetimeve konform nenit 12 ZPD, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet që lënda të procedohet në komision Disiplinor me arsye se ndaj të njëjtit, është shprehur në mënyrë jo të duhur në shkresat e lartëcekura gjatë prononcimit në emisionin Interaktiv, dhe me këtë ka rënë në kundërshtim me nenin 37 dhe

38 të KEPA-së, propozon që t'i shqiptohet masa disiplinore nga neni 118 par.1.3 i Statuit të OAK-së lidhur me nenin 5, 6, 7, 8, 37 dhe 38 të KEPA-së.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paraqiturit _____, në pyetjen e kryetarit të kolegjit se a e ka kuptuar Propozimin e Prokurorit Disiplinor dhe e pranon apo nuk e pranon përgjegjësinë disiplinore që i vihet në barrë, _____ të cilin ai e përfaqëson deklaroi: se e ka kuptuar Propozimin e Prokurorit Disiplinor të OAK-së, dhe nuk e pranon fajësinë në emrin e të autorizuarit të tij.

Kolegji Disiplinor pas deklarimit të Prokurorit Disiplinor dhe përfaqësuesit të autorizuar të të paraqiturit _____, konform neni 30 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikant, vazhdoi me procedurën e administrimit të provave, me ç'rast u lexuan: Propozimi i ZPD-së nr.8-3/2021 i dt.10.09.2021; Fletëparaqitja nr.133/2020 e datës 30.01.2020; Njoftimi nr.8-1/2020 i dt.25.06.2020; Përgjigje nga av. _____ nr.8-1/2020 e dt.14.07.2020; Artikulli i portalit " _____", i dt.22.01.2020; Artikulli i portalit " _____", lidhur me emisionin Interkativ i dt.23.01.2020; Fjala përfundimtare e avokatit _____ në lëndën PKR.nr.46/18; CD me sekuencat e emisionit " _____" të datës 22-23.01.2020; Vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr.108/2017 i datës 09.03.2017; dhe Vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr.46/2020, i dt.31.01.2020.

Kolegji Disiplinor pas administrimit të provave të cilat kaluan pa vërejtje nga Prokurori Disiplinor dhe përfaqësuesi i të paraqiturit, në kuptim të neni 33 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikant të OAK-së, i dha fjalën përfaqësuesit të të paraqiturit që të paraqesë mbrojtjen.

I autorizuari i të paraqiturit _____ në paraqitjen e mbrojtjes deklaroi: Shkelja e pretenduar Disiplinore nga ana e Prokurorit Disiplinor, është parashtruar me përdorimin e fjalëve jo adekuate dhe jo të duhura në: 1. Gjykatë dhe 2. Në emisionin Interaktiv dhe atë në mënyrë që nuk e ka ruajtur autoritetin dhe respektin e Prokurorit të Shtetit.

Sa i perket përdorimit të fjalëve në Gjykatore të njëjtat kanë qenë adekuate dhe shumë të duhura sepse në të kundërtën Gjyakta do të shqiptonte dënim Avokatit dhe Gjykata do ta ruante autoritetin e prokurorit.

Sa i përket prononcimit në emisionin interaktiv është mjet i veprimit i lejuar nga avokatët sidomos për rastin ku shumica e mediave kanë bërë transmetim subjektiv të një gjykimi publik.

Kolegë të nderuar çdo fjalë duhet të interpretohet në korelacion me tërë fjalët e tjera të shqiptuara e këto fjalë në korelacion me qëllimin e shqiptimit të fjalëve. Nga propozimi kam kuptuar se është fjala për dy fjalë, "Ndërgjegjje e sëmurë. Që të konsiderohet si fjalë në kuptim prezhorativ duhet të kenë së pari kuptim. Fjala sëmundje në vete paraqet përshkrim anomal të gjendjes fizike apo mentale, ndërgjegjja në bazë të fjalorit nuk hyn në kuadër të trupit fizik e as të mendjes. "Ndërgjegjja e sëmurë" më tingëllon si metaforë sepse e kundërta e saj është ndërgjegjje e shëndetshme. Nuk egziston në shkencë e as në praktikë njohuri qoftë për ndërgjegjje të sëmurë e ashtu edhe të shëndetshme.

Pas paraqitjes së mbrojtjes nga i autorizuari i të paraqiturit _____, kryetari i kolegjit disiplinor konform neni 34 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikant, i ftoj palët që të paraqesin fjalën përfundimtare.

Prokurori Disiplinor në fjalën përfundimtare deklaroi: Pas administrimit të provave besoj plotësisht se komisionit në provat e paraqitura i është sqaruar se _____ ka përodrur shprehje jo adekuate, ka fyer prokurorin _____ duke përdorur shprehjet se "Aktakuza nuk

ishte e por e nuk duhet të të frigohet nga askush por nga ndërgjegjja e tij e sëmurë”, “Ai komplet ka treguar se është pjesë e klanit”, “Në vend se ta ndihmonte Gjyginin fati i të gjithëve varej nga”. ZPD konsideron se qëndrimi i avokatit ndaj palëve, institucioneve dhe autoriteteve tjera duhet të jetë në pajtim me aktet e OAK-së.

Andaj të nderuar anëtar të Komisionit Disiplinor, ZPD nga provat e administruara konsiderojmë se janë përmbushur kushtet që Av. t'i shqiptohet masë disiplinore për shkelje të nenit 118 par.1.3 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenet 5, 6, 7, 8, 37, dhe 38 të KEPA-së.

I autorizuar i të paraqiturit në fjalën përfundimtare deklaroi: Fjala ime përfundimtare është si në arsyet e dhëna në mbrojtje, duke shtuar se pas fjalës përfundimtare për Prokurorin Disiplinor ku i njëjti gjatë citimit të dispozitave të caktuara e citoj se avokati në rend të parë duhet ta mbrojtë interesin e palës kjo gjë edhe ka ndodhur.

Kolegji Disiplinor nga provat e administruara vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Nga CD me sekuenca e emisionit “ ” në të dt.22-23.01.2021, gjatë deklarimit të të paraqiturit , lidhur me rastin gjyqësor ku ishte dënuar klienti i tij, ndërsa prokuror i çështjes kishte çenë ushtruesi i fletë-paraqitjes , **u vërtetua fakti se i paraqituri** , ndër të tjera deklaroi përkatësisht përdori fjalët “Aktakuza nuk ishte e , Aktakuza ishte e ”, “ duhet të frigohet nga ndërgjegjja e vet e smurë”, “ komplet ka treguar se është pjesë e ”, pastaj ky deklarim dhe këto fjalë janë botuar edhe në portalin , në artikullin e dt.23.01.2020, me titull “Avokatët i quajnë skandaloze vendimet në rastin “ ”, thonë se shkalla e dytë di t'i rrëzoj”.
- Nga kopja e artikullit të dt.22.01.2020 me titull “Krejt çka ndodhi në seancën e zhurmshme të dënimit të grupit ”, publikuar në portalin , **u vërtetua fakti se i paraqituri** ndër të tjera deklaroi përkatësisht përdori fjalët “ e dënoj ”.

Kolegji Disiplinor, pas shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit në tërësi të rrethanave të rastit, Propozimit të Prokurorit Disiplinor dhe provave tjera të bashkangjitura në shkresat e lëndës, mbrojtjes së të autorizuarit të të paraqiturit, fjalës përfundimtare të prokurorit disiplinor dhe të të autorizuarit të të paraqiturit, erdhi në përfundimin se përdorimi i fjalëve “Aktakuza nuk ishte e Aktakuza ishte e ”, “ duhet të frigohet nga ndërgjegjja e vet e sëmurë”, “ komplet ka treguar se është pjesë e ”, dhe “ e dënoj ”, nga i paraqituri av në media, paraqet shkelje të nenit 118 par.1 nën par.1.3 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenet 5, 6, 8, 37 dhe 38 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokati dhe Praktikant, dhe se avokati është përgjegjës për këtë shkelje.

Deklarimet e të paraqiturit sipas nenit 118 par.1 pika .13 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenet 5, 6, 8, 37 dhe 38 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokati dhe Praktikant, Kolegji i konsideroi si shkelje të rëndë, pasi që me këto deklarime dhe me përdorimin e fjalëve të tilla i paraqituri, ndaj institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe Gjykatës ka paraqitur qëndrimin e tij në kundërshtim me aktet normative të OAK-së, gjatë deklarimit në media nuk ka shprehur respektin e duhur ndaj prokurorit të rastit, dhe Gjykatës ka dhënë deklarata fyese dhe mendime nënçmuese ndaj të njejtave, dhe se këto deklarata janë në kundërshtim me dispozitat dhe frymën e Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit.

Megjithatë, Kolegji të paraqiturit i shqiptoi masën Vërejtje, të paraparë për këtë shkelje në nenin 51 par.1 pikal.1 të Ligjit për Avokatinë Nr.04/L-193, lidhur me nenin 122 të Statutit të OAK-së, dhe atë, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Kolegji e vlerësoi si rrethanë lehtësuese të kaluarën disiplinore të të paraqiturit, ku sipas shënimeve të Odës, i njëjti nuk figuron të ketë vendim të formës së prerë për ndonjë masë disiplinore në të kaluarën. Ndërsa si rrethana rënduese Kolegji gjeti se i paraqituri gjatë deklaramit katër herë dhe në dy medime të ndryshme është deklaruar me fjalë fyese dhe nënçmuese ndaj Gjykatës e veqanërisht ndaj Prokurorit të shtetit në rastin konkret ish-prokurorit

Kolegji gjithashtu vlerësoj se me deklarta të tilla siç ka bërë i paraqituri në këtë rast, cenohet edhe autoriteti i avokatisë dhe dëmtohet imazhi i Odës së Avokatëve. Andaj kolegji vendosi për këtë lloj dhe lartësi të masës, me bindjen se është masë adekuate dhe e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të masës disiplinore.

Kolegji vlerësoj edhe provat e tjera në shkresat e lëndes siç janë: Fjala përfundimtare e në lëndën PKR.nr.46/18, Vendimi i Këshillit prokurorial të Kosovës KPK/Nr.108/2017 i datës 09.03.2017; dhe Vendimi Këshillit prokurorial të Kosovës KPK/Nr.46/2020, i dt.31.01.2020, por vlerësoj se nuk kanë ndonjë relevancë dhe nuk provojnë ndonjë fakt për vendosje ndryshe në këtë çështje disiplinore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës dhe paushallin disiplinor, Kolegji vendosi që i paraqituri të ngarkohet vetëm me paushallin, sepse shpenzime për ekspert, dëshmitarë dhe përkthyes nuk kishte. Vendimin për paushallin, u mor në bazë të nenit 37 paragrafi 1, të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikantë.


Me bindjen e plotë se, vendimi i Kolegjit në këtë çështje disiplinore është krejtësisht në përputhje me Ligjin e Avokatisë dhe normativën e Odës, me bindjen se për këtë çështje nuk mund të vendosej më mirë dhe më drejtë se kështu, Kolegji vendosi ashtu si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V.KD. NR. 5-4/2021, dt. 25.10.2021

Procesmbajtësja
Ma.sc.Vjollca Ajeti



Kryetar i Kolegjit Disiplinor
Av. Bajram Lajqi



KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Komisionin e Ankesave të OAK-së, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa i dërgohet Komisionit të Ankesave në OAK, përmes këtij Komisioni.